REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 858/20
Datë/Datum. 05.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar BIBAJ – Exp. Shqyrtues	***Data e autorizimit të ekspertit*** *27.10.2020*	*Data e dorëzimit të raportit* *05.11.2020*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 26.10.2020, OE "Sallahu"shpk - Kacanik, ka parashtruar ankesë me nr: 858/19, , kundër njoftimit për dhënie të kontratës ne lot 1 dhe 7, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i rrugëve ne pjesët rurale me infrastruktur përcjellëse",me nr. të prokurimit: 616-20-2390-5-1-1, (Lot 1), iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtine.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, të negociuar,të kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 2,290,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Ak, sipas Oe ankues:
Neni 7, 27, 28, 51, 56, 59, 60, 69 dhe 108/A ,te LPP-se
Deklarata Detale
Në përputhje me Dosjen e Tenderit, të publikuar nga AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës , Kompania ''Sallahu"Shpk, me datë 13.07.2020 duke i'u përmbajtur të gjitha specifikimeve teknike dhe profesionale , kushteve dhe kritereve të kërkuara , paraqet ofertën përmes sistemit E-prokurim për LOT 1 dhe LOT 7 në këtë aktivitet të prokurimit.
Pas vendimit të parë të AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës me të cilin e shpërblen me kontratë OE Bujar Shabani B.I , kompania jone parashtroj kërkese për rishqyrtim për Lot 1 dhe Lot 7 , me ç'rast AK KK Prishtinë u pajtua qe OE i shpallur fitues për Lot 1 ishte i papërgjegjshëm dhe e ktheu lëndën ne rivlerësim

vetëm për Lot 1.

Pas rivlerësimit AK për LOT 1 shpallë fitues Kema Company (që ka qenë fitues për LOT 4), dhe për LOT *4* shpailë fitues OE Bujar Shabani B.I (që ka qenë fitues për LOT1).
Qëllimi ishte që këtë Kompani ta shpërblejë me ndonjë nga Lot-ot edhe pse ishte i pa Përgjegjshëm.
Pas rivlerësimit Autoriteti Kontraktues, me qëllim që OE Bujar Shabani B.I ta shpërblejë me kontratë me ndonjë nga LOT-ot e këtij Aktiviteti të Prokurimit ,vendosë që të ndryshojë fituesit për Lot te tjerë edhe pse nuk kishte kërkesa per rishqyrtim , me ç'rast duke shkelur kështu edhe mbi LPP dhe rregullat dytësore të prokurimit publik, ka bere korrigjimin e dhënies se tenderit ne formën e cila nuk është e parapara ne baze te LPP dhe as aldeve dytësore , pra nuk ka forme as procedure për korrigjim te dhënies .

Me datë 13.10.2020 duke qenë palë e dëmtuar dhe me interes parashtrojmë ''Kërkesën për rishqyrtim" në Autoritetin Kontraktues, duke kërkuar që kjo procedurë e prokurimit për LOT 1 të kthehet në rivlerësim ose të anulohet tërësisht pasi që me rastin e rivlerësimit janë bërë shkelje serioze të një sërë neneve të LPP-së dhe rregullave dytësore të prokurimit publikMe datë 6.10.2020 pranojmë vendimin e AK mbi refuzimin e kërkesës për ishqyrtim, dhe e vërteton njoftimin mbi vendimin e AK për pjesën e parë të publikuar me datë 08.10.2020.

Me vendimin e datës 08.10.2020 Autoriteti Kontraktues ka kthyer në rivlerësim edhe Lot 4- i cili nuk ka qenë objekt rivlerësimi, saktësisht nuk është bërë ankesë nga operatorë të tjerë , që do të thotë se për këtë Lot ka kaluar afati i ankesave dhe kontrata i është dhënë Kema Company, dhe as nuk është nxjerrë vendim nga Autoriteti Kontraktues për rivlerësim të këtij Lot-i, dhe për të cilin nuk janë krijuar kushte ligjore për rivlerësim.

Kjo është edhe shkelje e Dosjes së Tenderit, në të cilën thuhet se numri maksimal i Lot-ove që do të shpërblehet një kontraktues është 1, dhe meqenëse vetë AutoritetiKontraktues me vendim ka shpallë OE Kema Company fitues për LOT 4 , për LOT
1 më nuk do të duhej të ishte në garë, dhe me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka shkelur edhe mbi vendimin e datës 15.09.2020 me të ciliix ka vendosur të shpërblejë OE të caktuar për Lot-ot e aktivitetit të Prokurimit.

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se ka respektuar LPP dhe rregullat dytësore, nuk vlenë në këtë rast sepse nenet 27/A dhe 59 të LPP-së /' referohen procesit të vlerësimit dhe jo rivlerësimit të kontratave.
Sa ipërket citatit të cilin e ka përdorur nga RROUPpika 29 Ndarja e kontratave me lot- e.
Edhe kjo pikë i referohet procesit të vlerësimit, dhe jo të rivlerësimit.
E theksojmë sepër këtë LOT (LOT 4) nukjanëpërntbushur kushtet ligjorepër ta kthyer në rivlerësim, sepse nuk ka pasur ankesa. Arsyetimi i Autoritetit Kontratkeues qëpër Lot-e të shpërblejë operatorin i citi ka ofruar çmimin më të tirë të mundshëm, është dashur të merretparasysh qysh në vlerësimin e parë, dhejo të shpalien operatorët e papërgjegjshëm me paramasa të pa pfotësuara fitues, dhepastaj me qëllim të kurdisjes së tenderëve, të kthehen në rivierësim pa asnjë vendim dhe procedurë iigjore edhe Lot-ot e tjera për të cilat ritheksojmë se nuk janë përmbushur kushtet Hgjore.
Pasi AK per LOT 1 shpallë fitues Kema Company (që ka qenë fitues për LOT 4), dhe për LOT 4 ta shpallë fitues OE Bujar Shabani B.I (që ka qenë fitues për LOTl)

Për këto veprime nuk nxjerrë vendim pas rivlerësimit, mirëpo ''Korigjim i njoftimit mbi vendimin e

autoritetit kontraktues".
Në këtë rast është dashur të përdoret forma B58- ''Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues sepse këtu nuk kemi të bëjmë me korrigjime të gabimeve, mirëpo rivlerësisn pas shkeljeve të Ligjit të Prokurimit Publik nga Autoriteti Kontraktnes.
Mirëpo shkeijet nga Autoriteti Kontraktues nuk mbarojnë me kaq.

Pas rivlerësimit të LOT 1 ,Autoriteti Kontraktues rikthen kompanitë të cilat i kishte eliminuar nga lista e operatorëve të përgjegjshëm mirëpo vendimin e parë. Në listë të Operatorëve Ekonomik të përgjegjshëm sërish është edhe Kosova Asfalt me paramanës e pa plotësuar për të cilin kishim parashtruar Kërkesë për rishqyrtim,dhe si i tillë do të duhej të eliminohej nga procedura e tenderimit sepse nuk është i përgjegjshëm, mirëpo edhe po të ishte i përgjegjshëm Autoriteti Kontraktues e ka shpërblyer me kontratë për LOT 7 dhe nuk do të duhej të ishte fare në listë për LOT 1, pasi që numri maksimai i fitimit të kontratës për Lot-o është

1.
Për këtëgjeni të bashkangjitur njoftimin e datës 08.10.2020 ku shihet se Kosova Asfalt është në iistë të tenderuesve tëpasuksesshëm për LOT1. Pra nuk është etiminuar nga lista e tenderuesve për LOT1 duke ditur që është ipa përgjegjshëm dhe ka paramasën e pa plotësuar, dhe arsyeja tjetër se Kosova Asfalt është shpërblyer me LOT 7,dhe automatikisht do të duhej të mos ishte fare në garëpër LOT 1 sepse numri maksimat i fitimit të kontratave lidhur me këtë aktivitet është 1Pra mund ta shiltni se kemi të bëjmë me shkelje të dyfishtë të Dosjes së Tenderit dhe LPP-së.
Dhe nuk është e vërtetë se Autoritetit Kontraktues ka ngritur në sistemin eiektronik ndonjë raport të vlerësimit, dhe për këtë e keni të bashkangjitur me dëshmi nga publikimet në e-prokurim lidhur me këtë tender.

Duke marrë parasysh se është vendim jo ligjor, mirëpo dhe sikurse të ishte vendim në harmoni me ligjin, prapë po ju ofrojmë dëshmitë të cilat operatorin ekonomik Kema Company e bëjnë të pa përgjegjshëm dhe i cili ka ofruar dosje të ofertimit jo në përputhje me kushtet dhe kriteret e kërkuara të Dosjes së Tenderit.

OE Kema Company , i cili ka ofruar dosjen e ofertimit me pajisje të marrura me qira nga OE Eskavatori i cili po ashtu ishte ofertues në këtë aktivitet të prokurimit me të njëjtat pajisje për LOT 1, duke shkelur kështu LPP-në.
OE Kema Company merr 15 paisje me qira nga OE Eskavatori, nga 19 sa ishin kërkuar në Aneks 7.
OE Kema Company ishte shpallur fitues edhe per Lot 4 po me këto paisje, dhe supozojmë që po të shpallej fitues OE Eskavatori për Lot 1 si do të realizoheshin punët e projektit me të njëjtat paisje nga dy operatorë të ndryshëm ?!

Paisjet të cilat i ka marrë me qira Kema Company nga OE Eskavatori;

1. Automjet Special 05-492-AK
2. Kamion Kiper 2 dyer 05-719-AK
3. Kamion Kiper dy dyer 05-176-EL
4. Kamion Kiper dy dyer 05-178-EL
5. Kamion Kiper dy dyer 05-175-EL
6. Kamion Kiper dy dyer 05-179-EL
7. Cilinder Bomag BW212 D-3 nr.shasise 101580351191
8. Cilinder Bomag BW212 D-3 nr.shasisë 101580351188

9. Cilindër HAMM WALZE
10. Cilinder 3412-HT
11. Eskavator Case Baggerlade 695 SR
12. Eskavator Case Raupengaber CX 290B
13. Eskavator Case MobileBager WX-145
14. Moto Graider Bomag BG 160 T
15. Finisher per shtrirjen e asfaltit Vogele Super 1800-2

OE Kema Company ka mungesë të theksuar të dokumentacionit në dosjen e Ofertimit, dhe si i tillë duhet të shpallet i papërgjegjshëm dhe jo të shpërblehet me kontratë.

l.Sipas FDT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 2 kërkohet; Përpunetorët e paraqitur në Administraten Tatimore te Kosovës, deklaratë nga OE se posedon 30punëtor tëparaqitur në ATK)

Në ofertën e Kema Company mungon deklarata se OE ka të paraqitur mbi 30 punëtore në ATK, që është kërkesë e Dosjes së Tenderit, dhe me këtë rast OE nuk ib) dispozita e LPP-së ose ligji dytësor që pretendohet se është shkelur.
c) argumentet e ankuesit në mbështetje të pretendimit. përmbushë kushtet dhe kriteret e kërkuara *Autoriteti Kontraktues nuk arrijnë të arsyetojë këtë shketje Hgjore, dhe thekson OE Kema se ka ofruar vërtetimet nga A TK.*
Vërtetimet ngaATK duhet të ofrohen si dëshmi, pra mbështetje e deklaratës së kërkuar të dosjes së tenderit, dhe nuk janë zëvendësim i njëra tjetrës. Nuk ka asnjë deklaratë nga Kema Company ashtu siç e kërkon Dosja e Tenderit, dhe kjo pikë është në kundërshtim me nenin 59 pika 4 i LPP-së
Citoj nga FDT ; *Përpunetorët eparaqitur në Administraten Tatimore te Kosovës,deklaratë nga OE seposedon 30punëtor tëparaqitur në ATK) Vetë Autroriteti Kontrakues e pranon se nuk ka një deklaratë siç kërkohet, nga Kema Company.*
2. Në *Aneksin 7- Lista e paisjeve, pika 7 është kërkuar; Cisternë e ujit.*

Kema Company ka bashkangjitur Librezën e paisjes me targa 05-492-AK të SKADUAR , në të cilën ceket se është Automjet Special, mirëpo jo Cisternë e ujit ashtu siç kërkohet në Aneks 7, pika 7.

Autoriteti Kontraktues në rast se pranon paisje me dokumente jo valide, pra me regjistrim të skaduar është duke shkelur mbi ligjin nr. 05/L-132 Për Automjete, gjegjësisht neni 39pika 1 dhe 3 ku thuhet se mjetetpër të marrëpjesë në trafikun rrugor duhet të kenë regjistrim valid.

Aneksi 7 i Dosjes së Tenderit nuk është plotësuar konfrorm kërkesave të FDT-së , pjesa lidhur me të dhënat e pasjeve është e pa plotësuar, duke shkelur kështu nenin 28 të LPP.

3.Sipas FDT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 2 kërkohet; Dy (2) Inxhinier ose baçelor te ndërtimtarisë (Konstrukti ose Infrastrukturë) me dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotot
Ing.Saxhide Ujkani, Drejtimi Konstruktiv pas diplomimitmuaj (01.05.2018- 31.08.2018) sipas CV- së bashkangjitur në ofertë, dhe nuk ka asnjë dëshmi tjetër për përvojë të punës.
Mungojnë referencat siç kërkohet në Dosje të Tenderit.

Pra nuk e përmbushë kushtin e kërkuar të dosjes së tenderit që ing.pas diplomimit të ketë përvojë punë.
Në diplomën e bashkangjitur ka paraqitur dokumentin e noterizimit të diplomës i cili nuk është në emrin e Saxhide Ajdini, por të ''Dituror Sadikut".

Lidhur me këtë pikë Autoriteti Kontraktues e e ka cilësuar pretendimin tonë si pjesërisht të qëndrueshëm.
Në këtë rast është plotësuar Kushti Administrativ i refuzimit të ofertës sepse CVe e dorëzuar nuk i përmbush kërkesat (min 2 vite përvojë pune) Ndërsa Autoritetit Kontraktues i'u referohet pikës tjetër se CV nuk i përmbaninformatat e kërkuara, Autoritetit Kontraktues prapë shkeië LPP-në sepse nëse Autoriteti Kontraktues nese nuk ka mundur të vendosë është dashur të kërkojë informata pikërisht sipas neneve 72 të LPP-së dhe në këtë rast Autoriteti Kontrakutes nuk e ka përfillur këtë nen edhe as RROUP.
Arsyetimi se pas diplomimit kanë kaluar dy vite , ky është arsyetim qesharak dhe jo profesional për një Autoritet Kontraktues , sepse mund të kalojnë edhe 10 vite nga data e diplomimit e të mos punohet asnjë ditë pune.
Eshtë qesharake që Autoriteti Kontraktues të nxjerrë vendime mbi të tilla konkulzione.

4.Sipas FDT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 2 kërkohet; Nje (1) inxhinier I diplomuar i komunikacionit me me se paku dy vite pervoje pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar i komunikacionit me më se paku dy vite pervojë pune. pas diplomimit

Inxhineri i kërkuar i drejtimit Komunikacion të ketë përvojë pune mbi 1 vit pas diplomimit Ing Hajrulla Preniqi, Drejtimi-Komunikacion , ka CV të mangët me të dhëna të pakta, në të shkruan vetëm ; Përvojë pune 4 vite , mirëpo nuk ceket as institucioni/kompania, vitet e punës,detyrat apo përgjegjësitë, dhe asnjë dëshmi tjetër lidhur me përvojën pas diplomimit siç kërkohet në FDT , madje mungojnë edhe referencat siç kërkohet për stafin profesional.

Sipas RreguIlat dhe Udhësuesi Operativ i Prokurimit Publik në rastet kur ; CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat thuhet; Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm , duke i'u referuar nenit 69 të LPP-së.
Si e tillë kjo CV me të dhëna të cilat janë të pakta dhe nuk i përmbushin kërkesat paraqesin kusht për refuzimin e ofertës.

Lidhur me këtë pikë të kërkesës për rishqyrtim Autoritetit Kontraktues nuk është përgjigju fare.
Pasi që njësoj sikurse në pikën më lartë është bërë shkelje e LPP-se dhe rregullave dytësore të prokurimit publik. Nëse këto kërkesa Autoriteti Kontraktues nuk i cilëson si të rëndësishme, por parësore e vlerëson çmimin .
Nenet 51, 52 lidhur me nenit 56 obligojnë Autoritetet Kontraktuese që në përzgjedhje të kontratës të vierësojnë fillimisht kandidatët sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas parag.2 te nenit 52 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28, e pastaj të vlerësohet në përputhje me nenin 60 të LPP-së , që lë të kuptohet se në këtë rast , pavarësishtë se OE Kema Company ka paraqitur ofertë me çmimin më të lirë , fillimisht vlerësohet sipas nenit 51.2 dhe 28 të LPP-së , pra kushtet dhe kërkesat e përcaktuara të dosjes, dhe në rast se përmbushen këto kritere parësore, atëherë të vazhdohet tek pjesa e çmimit të ofertës. Siç shihet nga faktet të cilat i posedojmë , dhe i keni të bashkangjitura , OE Kema Company nuk i përmbushë kushtet dhe kriteret e FDT-së. Po e citojmë nenin 60 Kriteret për dhënien e kontratës ; Autoritetit kontraktues do t'ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ; Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; (e ritheksojmë ; të përgjegjshëm)
Neni 59 pika 4 LPP - Autoriteti Kontraktues do ta konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse

tenderi në fjalë është në përputhshmërie me të gjithakërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.

S.Sipas FDT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 6 kërkohet; OE Duhet të ketë Bazë për prodhimin e Betonit në Pronësi apo marrëveshje për furnizim me beton për të gjitha Lotot

Në marrëveshjen e furnizimit me beton nuk është cekur data se kur është hdhur marrëveshje.
Kjo marrëveshje nuk përmban titullin e projektit, dhe as nr.e prokurimit,dhe është vetëm një lloj i parakontratës , ku edhe vetë në NENIN 2 të kësaj kontrate ceket se Kjo marrëveshje do të filloj së implementuari vetëm pas nënshkrimit të kontratës së veçantë mes palëve Toni Company dhe Kema Company" ,që nënkupton se kjo marrëveshje nuk i plotëson kushtet e kërkuara për vlefshmëri për të gjitha Lot-ot pasi që nuk ceket as titulli i aktivitetit të prokurimit, as numri, dhe as Lot-ot.

Në Dosjen e Tenderit Pjesa 5 - Identifikimi Financiar

Mungon .

Meqënse tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara, konstatojmë se duke pasur dëshmitë dhe faktet OE Kema Company nuk i ka plotësuar kushtet e kërkuara të Njoftimit të Kontratës dhe Dosjes së Tenderit, dhe si i tilië duhet të shpallet i pa përgjegjshëm. Nga të dhënat e lartëcekura dhe dëshmitë e bashkangjtura, Autoriteti Kontraktues, ka shkeiur Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës,dhe rreguliat dytësore të prokurimit publik, duke shpaliur fttues një Operator Ekonomik , i cili nuk i ka përmbushur kriteret dhe kushtet e kërkuara në dosje të tenderit duke ofruar paisje qe nuk i përgjigjen kushteve dhe kritereve te dosjes se tenderit, pasi që me rastin e vierësimit , është shkelur neni 28, iidhur me nenin 59,pika 4, ku thuhet se Autoriteti kontraktues do ta konsideroj të përgjegjshëm një tender vetëm nëse tenderi në fjaië është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.
Në mbështetje të nenit 52 të LPP , vetëm kriteret e përcaktuara paraprakisht në dosje të tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Sot me datë 26.10.2020 Autoriteti Kontraktues KK Prishtinës ka paragjykuar procesin e vendimit nga OSHP-ja, duke vazhduar me nënshkrim të kontratave për LOT 2, LOT 3, LOT 4, LOT 5, LOT 6 , LOT 7, LOT 8.

Andaj duke pasur parasysh të gjitha shkeljet e lartcekura , Iidhur me vlerësimin dhe rekomandimin për OE fitues në këtë aktivitet të prokurimit,si dhe vendimin për rivlerësim edhe për Lotin 4 i cili nuk ka qenë fare objekt i rivlerësimit, kërkojmë që kjo procedurë të kthehet në rivlerësim për LOT 1.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, punë, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej Loto 1. 1.600.000,00 euro Loto 2. 100.000,00 euro Loto 3. 200.000,00 euro Loto 4. 200.000,00

euro Loto 5. 300.000,00 euro Loto 6. 200.000,00 euro Loto 7. 550.000,00 euro Loto 8. 150.000,00 euro

2. OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon o Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë (Menaxher i Projektit)– **min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit** (drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë). Udhëheqësi i punishtes duhet te ketë udhëhequr se paku 2 (dy) kontrate ne vlerën e parashikuar.- per Loton I dhe VII-te. o Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë (Menaxher i Projektit) – **min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit** (drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë). Udhëheqësi i punishtes duhet te ketë udhëhequr se paku 1 (një) kontrate ne vlerën e parashikuar.- per Loton II,III,IV,V,VI dhe VIII-te. o Një (1)inxhinier ose baçelor i diplomuar i gjeodezisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotot. o Dy (2) Inxhinier ose baçelor te ndërtimtarisë (konstrukti ose infrastrukture) me dy vite përvojë pune pas diplomimit - Për të gjitha Lotot. o Nje (1) inxhinier I diplomuar i hidroteknikes me me se paku dy vite pervoje pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar i hidroteknikes me me se paku dye vite pervoje pune pas diplomimit – Për të gjitha Lotot. o Nje (1) inxhinier I diplomuar i komunikacionit me me se paku dy vite pervoje pune pas diplomimit apo bachelor i diplomuar i komunukacionit me me se paku dy vite pervoje pune pas diplomimit - Loto I,III,IV,V,VI, dhe VII. - Operatori ekonomike duhet te ofroj dëshmi për min. 30 punëtor te paraqitur ne adnministraten taimore ne tre vitet e fundit për - vetem per LOT 1.
3. 3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.
4. OE duhet te kete Baze per Prodhimin e asfaltit ne Pronesi apo marrvershje per furnizim me asfalt - per te gjitha Lotot
5. OE Duhet te kete Gurethyes te licensuar ne Pronesi apo marrvershje per furnizim me zhavor - Për të gjitha Lotot
6. OE Duhet te kete Baze per prodhimin e Betonit ne Pronesi apo marrvershje per furnizim me beton Për të gjitha Lotot

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve. Shënim Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 Lote, shuma më e lartë e vleres se kontratave te realizuara që kërkohet për Lotet për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE. Shembull Nëse OE vendos që të konkurrojë në Lot 1 dhe 2, atëherë kërkesa minimale e puneve te realizuara e cila duhet të përmbushet nga OE është 1,600,000.00 euro. nëse OE vendos qe te konkurroj ne Lot 2 dhe 3, atëherë kërkesa minimale e puneve te realizuara e cila duhet te përmbushet nga OE është 200,000.00 euro
2. Per inxhinieret e kerkuar duhet deshmuar CV-a, Diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marrveshja mbi angazhimin per kete projekt. Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punedhenesi per menaxher i projektit, ndersa per punetoret e paraqitur ne administraten tatimore te kosoves, deklarate nga OE se posedon 30 punetor te paraqitur ne ATK
3. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen, ndersa per automjetet qe regjistrohen duhet deshmuar me Librezat e qarkullimit. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin e automjeteve, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim te automjeteve.
4. Kopja e licences e vlefshme e leshuar nga Agjencioni per miniera dhe minerale. Ne rastet kur OE

ka mareveshje per furnizim, OE duhet te dorezoj edhe kopjen e marreveshjes per furnizim.

5. Kopja e licences e vlefshme e leshuar nga Agjencioni per miniera dhe minerale. Ne rastet kur OE ka mareveshje per furnizim, OE duhet te dorezoj edhe kopjen e marreveshjes per furnizim.
6. OE Duhet te kete Baze per prodhimin e Betonit ne Pronesi apo marrvershje per furnizim me beton Për të gjitha Loto.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

.

AK, per lot 1, ka rekomanduar OE "Kema Company" shpk

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA .

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtine, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie te kontratës ne lotin 1.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113): Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se AK/ Komuna Prishtine fillimisht për lotin 1, te këtij aktivitetit te prokurimit kishte rekomanduar për dhënie OE "Bujar Shabani BI, me datën 15.09.2020 ne vlere prej 684, 724.85 €, përderisa me datën 08.10.2020, publikon, korrigjimin e njoftimit mbi vendimin e AK-se, ku ne lot 1, dhe rekomandohet për dhënie OE "Kema – Company" shpk & Pro & "Co Group" shpk ne vlere prej 737, 830.00€, përderisa ne lot 4, OE "Bujar Shabani B.I",(loti 4, sipas shkresave te lendes te ngarkuara ne e-prokurim, nuk është kontestuar nga OE).

Pretendimet tjera ankimore qe kane te bëjnë kundër operatorit ekonomik te rekomanduar për dhënie ne lotin 1, përkatësisht kontestohen kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, te cilat do ti trajtojmë ne mënyre te përgjithësuar.

Si fillim kontestohen pajisjet e punës te prezantuara nga OE te rekomanduar ne lotin 1, te këtij AP, i njëjte, ku potencohet se ne lotin 1. OE i njëjtë përveç pasjeve tjera ne oferte ka prezantuar edhe pajisje ne emër te OE "Ekskavatori" te cilit kontrata i është dhënie ne lotin 4. (Për te gjitha lotët janë kërkuar pajisje

teknike)

Si prove se bashku me raport gjeni marrëveshjen e datës 13.07.2020.

Pretendimi tjetër ka te beje me punetoret e deklaruar ne ATK, përkatësisht potencohet se nuk janë prezantuar 30 punëtor. OE i njëjte ka aplikuar ne grup/konzorcium dhe sipas deklaratave për punëtoret e prezantuar, rezulton qe te dy anëtaret e grupit e mbulojnë kërkesën e AK-se, për minimumin 30, punëtoret e kërkuar. Përderisa lidhur me librezën e qarkullimit, sipas numrit te regjistrimit 05-492-AK, përmes kërkesës nuk është aplikuar si kerkese nga AK, validiteti i qarkullimit rrugor, ne te njëjtën libreze përshkrimi i automjetit është "automjet special", ndërsa tek lista e pasjeve te prezantuara përshkruhet edhe Cisterne e ujit, per te cilin nuk mund te vlerësojmë nëse mjeti eshte cistern e ujit apo jo.

- Si prove bashkangjitur gjeni deklaratat e ATK-se, te prezantuara ne oferte.

Pretendimet tjera ankimore kane te bëjnë kundër stafit profesional, përkatësisht kundrejt, znj Saxhide Ajdini, dhe Hajrulla Prenaj. AK përmes kërkesës se dosjes se tenderit për lot 1 dhe 7, kundrejt projekt menaxherit ka kërkuar variante te përvojës se **punës 5 dhe 3 vite përvoje pune**.

Është kërkuar edhe staf tjetër me përvojë **nga dy vite** pas diplomimit. Znj. Ajdini, e kontestuar nga ankuesi rezulton qe e njëjta studimet i ka përfunduar me datën 12 prill 2018, ku ka marr titullin Bachelor i ndërtimtarisë, programi studimor –Konstruktiv. Për loti 1, AK kundrejt inxhinierëve ka kërkuar qe te njëjtit si dëshmi dokumentare te prezantojnë CV, diplome, kontratat e punës dhe referenca për punët e mëparshme. Kundrejt znj Ajdini, është prezantuar kopja e diplomës, kontratës dhe CV. Përderisa kundrejt z. Hajrualla Preniqi kopja e diplomës, me kualifikim bacelor i trafikut rrugor dhe transportit, si dhe CV. Për te njëjtit nuk janë prezantuar dëshmi – Referenca për punët e kaluara siç është kërkuar nga AK.

Po ashtu parashtruesi i ankesës konteston edhe marrëveshjen e bashkëpunimit – Furnizim me beton te lidhur nga "Kema Company" shpk me "Toni Compani"shpk, përkatësisht kontestohet marrëveshja pasi qe nuk posedon date te lidhjes se marrëveshjes, per te cilat AK, pergjat vlerësimit te ofertave ka mundur ti sqaroj bazuar ne LPP.

Përfundimisht sipas asaj qe u përshkrua si me larte, propozimi ynë për AK, është qe lënda te kthehet ne ri-vlerësim, me qellim qe te pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave, përkatësisht te vet vlerësohet nëse me variante te kërkesave te kualifikimit mund te kemi vlerësim real, bazuar ne dispozitat ligjore për prokurim publik ne përgjithësi dhe ne veqanti nenin 59.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht a bazuar, te anulohet prozimi per dhënie ne dhe loti 1, te kthehet ne **Ri vleresim.**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna Prishtin.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - Sallahu, shpk - Kacanik.

Provë 1

DRAFT KONTRATE
DHENIA E MJETEVE ME QIRA

E lidhur ne Ferizaj, me: 13.07.2020, në mes:

1. **Companya "Eskavatori " shpk**, me numer unik identifikues **810646169** dhe adrese: maxhistrala Ferizaj-Shkup, Ferizaj, perfaqesuar nga drejtori **Isa Rysha - Qiradhenesi,**

2. **"Kema Company" sh.p.k.** me numer unik identifikues **810382309** dhe adrese: QMI, Lipjan, perfaqesuar nga drejtori **Blerim Kolshi – Qiramarresi**

Nr i prokurimit	616-20-2390-5-1-1
Nr i brendshëm	616 20 039 511

Titulli: Ndertimi i rrugeve ne pjeset rurale me infrastrukture percjellese – Te gjithe Lotet

Qiradhenesi eshte pronar i mjeteve ndertimore andaj te njejtat ia ofron me qira qiramarresit.

Mjetet te cilat Qiradhenesi i ofron me qira jane te pershkruara ne listen e mjeteve te kompanise qiramarrese si mjete te huazuara.

Companya „ESKAVATORI" sh.p.k

ESKAVATORI Sh.p.k

Lot 7. "Kosova Asphalt" Prove B

3.5	Hapja e kanaleve per largimin e ujrave atmosferike sipas detaleve në projekt.	m'	1,000.00	0.40	400.00
3.6	Furnizimi, bartja dhe vendosja e kanaletave nga betoni me d=70cm, si dhe gurit skajorë standart 18/24, MB40 M100 I vendosur në shtresë betoni MB20	m'	100.00	30.00	3,000.00
	GJITHËSEJ PUNËT E MBISTRUKTURES				148,018.33

4	Lëshesat				
4.1	Gërmimi I dheut të kater: III dhe IV në thellsi 0-3m per vendosjen e lëshesave.	m^3	552.00	1.00	552.00
4.2	Furnizimi, Shtruerja dhe kompaktimi i zhavorit si baz e vendosjes së themeleve të Lëshesave	m^3	56.00	6.00	336.00
4.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave monolite ose montazhe me koka hyrëse-dalëse si dhe perforcim nga betoni, punimi komplet sipas detaleve në projekt.			?	0.00
	a) Ø 600mm	m'	138.00	30.00	4,140.00
	a) Ø 1000mm	m'	88.00	48.00	4,224.00
4.4	Furnizimi transporti dhe punimi I pusetave per grumbullimin e ujrave atmosferike në hyrje të lëshesave duke perfshir te gjitha pozicionet (Betonin dhe armimin), dimensionet e mbrendeshme të pusetes:1.0x0.8x1.5 sipas detaleve në vizatime.	copë	1.00	100.00	100.00
4.5	Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave monolite ose montazhe me koka hyrëse-dalëse,punimi komplet (kryqezimet me rruge lidhese) Ø 500mm	m'	50.00	35.00	1,750.00
	GJITHSEJ LËSHESAT RRETHORE				11,102.00

5	TË NDRYSHME

Provë 2

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KS\barudi

7/7/2020 11:25:52 AM

NR FISKAL	810382309
EMRI I KOMPANISË	Kema - Company SH.P.K.
ADRESA	Te QMI-a
LLOJI I BIZNESIT	JURIDIK
QENDRA TATIMORE	PRISHTINË 3
VITI	2018

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
Njësia Org. / Org. jedinica / Org. Unit: ATK
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 552
Nr. faqeve / Broj listova / No. pages: 3
Data / Datum / Date: 07.07.2020
Dalësa: Q SH T PRISHTINË

NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIMARE	MUAJT 1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	SYZANE	ISUFI	1004581870	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
2	BLERIM	KOLSHI	1013038232	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
3	GANI	PRUSHI	1011940702	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
4	NAIM	KOLSHI	1005396758	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
5	ADRIAN	DEMA	1230016433	JO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
6	ZIJADIN	GURI	1004456129	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
7	ARTA	MALIQI	1004581896	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
8	SANIJE	KOLSHI	1003513838	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
9	ARSIM	KOLSHI	1005396944	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
10	AGIM	DEDA	1173719341	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
11	RUZHDI	MUSA	1012868118	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
12	BURHAN	KOLSHI	1171045637	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
13	SHQIPRIM	KOLSHI	1175519404	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
14	ERMIRA	BYTYÇI	1173747671	JO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
15	RAMADAN	BEKTESHI	1005393465	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
16	FAIK	DEDA	1004582825	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
17	BURIM	KOLSHI	1173548555	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
18	RITA	MUSLIU	1231335397	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
19	KADRI	KOLSHI	1030806669	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
Q SH T
PRISHTINE

Provë 2

7/1/2020

Printing Report

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

Lista e Punëtorëve

Periudha	2019

Numri Fiskal	811092254	Kontakti	KENAN EMINI
Tatimpaguesi	Pro & Co Group SH.P.K.	Adresa	p.n.
Regjioni	GJILAN	Tel	045 777 757
Lloji Kompanisë	SH.P.K.	Aktiviteti	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore

				MUAJT											
Nr.	Emri	Nr. Personal	Primare	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	AGRON SHABANI	1173758037	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
2	ARMENDA BEQIRAJ EMINI	1171567951	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
3	BEKIM REXHEPI	1014594228	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
4	DAUT TERZIU	1005395883	JO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
5	FARUK TËRZIU	1004586626	JO	-	-	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
6	FISNIK EMINI	1233309563	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
7	FITIM AZIZI	1012290809	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
8	FITIM EMINI	1173310699	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
9	IBRAHIM LEKAJ	1004982769	JO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
10	KENAN EMINI	1171462629	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
11	KORAB HAXHIU	1233311495	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
12	LIRIK SAHITI	1175576041	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
13	LIRIM EMINI	1240343823	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
14	LORIK EMINI	1172638593	PO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
15	MIRLIND SINANI	1012567312	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
16	NAKIE EMINI	1231878617	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
17	NDERIM LEKA	1243874382	PO	-	-	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-
18	NEHAT HAZIZI	1012290825	JO	-	-	-	-	-	-	+	+	+	+	+	+
19	RAMADAN IBRAHIMI	1231231206	PO	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
20	SHABAN SELIMI	1230475667	JO	-	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
21	SHEMSIJE DEMIRI	1500554823	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
22	SHKODRAN ZUKA	1231232024	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
23	SINAN EMINI	1013322232	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+

7/1/2020 11:22:53 AM